

NJOFTIM

Në zbatim të VKM nr.780, dt. 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet e Arsimit të lartë", njoftohen të gjithë studentët e ciklit të dytë Master, që plotësojnë kushtet për reduktimin me 50% të tarifës së shkollimit për vitin akademik 2020-2021 se;

1. Afati i dorëzimit të dokumentacionit sipas kriterëve për përfitim të bursës, do të jetë nga data 14 deri në 22 Dhjetor 2020.

2. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet me anë të Postës Shqiptare në adresën:

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (Ish Fakulteti i Infermierisë)

"Rruga e Dibrës" Nr. 372, Brenda QSUT, Tiranë

3. Bashkëlidhur formulari i kriterëve dhe dokumentave që do të dorëzojnë studentët.

4. Dokumentacioni të jetë origjinal ose i noterizuar (përveç dokumentacionit të marrë nga e-albania).

5. Specifikisht vërtetimet e ndihmës ekonomike, aty ku kërkohet, duhet të jenë me nr. protokolli, me datë jo më vonë se tre muajt e fundit pa korrigjime, firmë dhe vulë të njomë. Të përcaktohet qartë vlera e ndihmës ekonomike me shifra e fjalë. Asnjë vërtetim i ndihmës ekonomike nuk quhet i plotë pa numrin e dosjes.

6. Studentët të cilët kanë mesatare mbi 9, përfitojnë përgjysmim automatikisht dhe nuk është e nevojshme të dorëzojnë dokumentacion si student në kategoritë në nevojë.

7. Saktësia e dokumentacionit përcakton nëse do të shpallen fitues ose jo.

8. Specifikisht **vërtetimi i ndihmës ekonomike të ketë të shënuar numrin e dosjes dhe të jetë shënuar qartë shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë), si dhe masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme). Vërtetimi duhet të jetë me numër protokolli, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur. Nuk pranohen vërtetime me korrigjime të pafirmosura nga personat përgjegjës dhe të pavulosura.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/_____

FORMULAR APLIKIMI PËR PËRGJYSMIM TARIFE SHKOLLIMI	
VITI AKADEMIK _____	
<i>Për studentët që ndjekin studimet në programet e ciklit të dytë Master Shkencor dhe Master Profesional</i>	
Datëlindja	
Nr. ID	
Programi i studimit	
Viti i Studimit	
Dega	
<p>Unë _____, student/e pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, paraqes kërkesën për të përfituar përgjysmim tarife shkollimi. Pasi plotësoj kushtet e përcaktuara në VKM Nr. 780, datë 26.12.2018, deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime si dhe dokumentacioni shoqërues që provon plotësimin e njërit prej kriterëve të renditura në vijim të kërkesës, të nënvizuara me shenjën X përbri kriterit, janë në dijeninë time të sakta dhe janë dokumenta zyrtare të marra nga institucione shtetërore dhe/ose të njohura me ligj.</p> <p>Jam në dijeni se deklarime të rreme nga ana ime në këtë kërkesë si dhe paraqitja e dokumentave të falsifikuara, përveç përgjegjësisë penale, sjellin automatikisht dhe heqjen e të drejtës për përgjysmim të tarifës. Dokumentat shoqëruese janë origjinale ose kopje të noterizuara sipas kërkeses.</p>	

Emër mbiemër i studentit _____

Nënshkrimi _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

**KRITERET DHE DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOJNË STUDENTËT QË
STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI CIKLI I DYTË “MASTER PROFESIONAL”
DHE “MASTER SHKENCOR” NË ZBATIM TË VKM NR.780, DATË 26.12.2018.**

(Masa e përfitimit 50% e pagesës së tarifës vjetore të studimit)

1. Studentë me aftësi të kufizuar të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, student që nuk shikojnë (Verbër)/student tetraplegjik/ paraplegjike/student me aftësi të kufizuar.

- a. Fotokopje të noterizuar të vërtetimit të KMCAP (Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë) ose të KMPV (Komisioni i Caktimit të Verbërisë);
- b. Vërtetim origjinal nga njësi e vetëqeverisjes vendore për pagesën e verbërisë/ paaftësisë që merr studentit;
- c. Vërtetimi nga shoqata e të verbërve të Shqipërisë ose nga shoqata përkatëse n.q. se ka;
- d. Fotokopje e noterizuar e Librezës së Verbërisë/Fotokopje e noterizuar e statusit të paraplegjik/ tetraplegjik; n.q. se ka.
- e. Fotokopje e kartës së identitetit të studentit.

2. Studentët fëmijë të personave/ familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCAP-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/ përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

- a. Kopje origjinale ose e noterizuar e vërtetimit të KMCAP-së (Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë) për studentin me prindër me aftësi të kufizuar (invalid pune, invalid paraplegjik, invalid tetraplegjik);
- b. Vërtetim që lëshon shoqata e invalidëve të punës së rrethit përkatës së bashku me fotokopjen me vulë të njomë të Dëshmisë së Invalidit të Punës të përfituar sipas statusit të invalidit të punës;
- c. Vërtetim origjinal të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit;
- d. Vërtetim nga njësi e vetëqeverisjes vendore në lidhje me masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja. Vërtetimi i ndihmës ekonomike duhet të ketë të shënuar numrin e dosjes dhe të jetë shënuar qartë shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë), si dhe masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme). Vërtetimi duhet të jetë me numër protokollit, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur. Nuk pranohen vërtetime me korrigjime të pa firmosura nga personat përgjegjës dhe të pavulosura;
- e. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me invalidin e punës/invalidin paraplegjik/ tetraplegjik;
- f. Fotokopje të kartës së identitetit të studentit dhe të prindit invalid.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

3. Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/ përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore,

a. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me kryefamiljarin familja e të cilit përfiton ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore në lidhje me masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja. Vërtetimi i ndihmës ekonomike të ketë të shënuar numrin e dosjes dhe të jetë shënuar qartë shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë), si dhe masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme). Vërtetimi duhet të jetë me numër protokoll, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur. Nuk pranohen vërtetime me korrigjime të pafirmosura nga personat përgjegjës dhe të pavulosura;

c. Fotokopje të kartës së identitetit të studentit.

4. Studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;

a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;

b. Çertifikatë vdekjeje e prindit që u është ndarë nga jeta;

c. Vërtetime që vërtetojnë të ardhurat vjetore të familjes, si më poshtë:

1. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore që familja përfiton ndihmë ekonomike si familje në nevojë;

2. Vërtetim për pagën nga punedhësi për prindin që jeton.

2. Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve që asnjë nga familjarët e studentit (personat mbi 18 vjeç) nuk ushtrojnë aktivitet privat;

5. Studentët që kanë përfutur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

a. Çertifikatë Familjare;

b. Fotokopje e kartës së identitetit

c. Çertifikatën e vdekjes së dy prindërve;

d. Fotokopje e noterizuar e statusit të jetimit të përfutur nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

6. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë

- 1) Rasti kur studenti e ka humbur përgjegjësinë prindërore nga të dy prindërit;
- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vendim gjykatë i formës së prerë që studenti ka humbur përgjegjësinë prindërore (nga të dy prindërit) Kopje origjinale ose kopje e noterizuar e vendimit të gjykatës)

6.1 Rasti kur studenti e ka humbur përgjegjësinë prindërore nga njeri prind dhe prindi tjetër nuk jeton

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vendim gjykatë i formës së prerë që studenti ka humbur përgjegjësinë prindërore (nga njeri prind) Kopje origjinale ose kopje e noterizuar e vendimit të gjykatës)
- c. Çertifikatë vdekjeje e prindit tjetër;

7. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktima të trafikut të qënieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qënieve njerëzore;

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vërtetim nga Ministria e Mirëqënies Sociale ose Ministria e Brëndshme që kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qënieve njerëzore;

8. Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brëndshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brëndshme dhe ajo e mbrojtjes;

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Çertifikatë vdekjeje e prindit që ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;
- c. Vërtetim konfirmimi nga Ministria përkatëse;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

9. Studentët romë dhe Ballkano-egjiptianë, konfirmuar si të tillë nga Ministria e Mirëqënies Sociale

- a. Fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vërtetim antarësie në shoqatën përkatëse;
- c. Vërtetim konfirmimi nga Ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;

10 Studentët fëmijë të ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

- a. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin të ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- b. Vërtetim i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik;
- c. Dëshmi penaliteti për prindin ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brëndshme.

11. Studentët e shkëlqyer që rezultojnë me notën mesatare 10 (dhjetë).

- a-Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë);
- b-Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.